



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 2558 Prot.

Tiranë, më 17.11.2020

**URDHËR**

Nr. 277, Datë 17.11.2020

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËRZGJEDHËSE TË KANDIDATIT PËR POZICIONIN  
E DREJTORIT TË NJËSISË MENAXHIMIT TË PROGRAMIT (PMU) “Italian-  
Albanian SME-s’ Development Programme - PRODAPS ”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 7 të ligjit nr. 9000, datë 30. 01. 2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 13. 09. 2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, “Marrëveshjeve ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane për realizimin e programit të ndihmës së integruar për shvillimin e NMV shqiptare” (*Marrëveshja*) dhe Manualit Operacional miratuar nga Komitetit i Linjës së Kredisë, me cilësinë e ministrit përgjegjës për ekonominë,

*Me cilësinë e ministrit përgjegjës për ekonominë;*

*Me qëllim, përzgjedhjen e kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Njesisë së Menaxhimit të Programit (PMU) “Italian-Albanian SME-s’ Development Programme - PRODAPS ” i cili do t’i propozohet për emërim Credit Line Steering Committee (CLSC),*

**URDHËROJ:**

1. Fillimin e procedurës përgjedhëse të kandidatit për për pozicionin e Drejtorit të Njesisë së menaxhimit të Programit (PMU) “Italian-Albanian SME-s’ Development Programme - PRODAPS ” i cili do t’i propozohet për emërim Credit Line Steering Committee (CLSC).

2. Njoftimi për fillimin e procedurës për pozicionin e lirë të punës dhe kriteret që duhet të plotësojë kandidati i mundshëm për këtë pozicion janë sipas Aneksit 1 të këtij Urdhëri.
3. Për zbatimin e procedurës dhe përzgjedhjen e kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Njesisë së Menaxhimit të Programit (PMU) “Italian-Albanian SME-s’ Development Programme - PRODAPS ” i cili do t’i propozohet për emërim Credit Line Steering Committee (CLSC), ngarkohet Komisioni i Vlerësimit më këtë përbërje:
 

- Z. Oltio Muzaka	✓ Sekretar i Përgjithshëm/MFE	Kryetar
- Z. Denis Demiri	Drejtor i Apelimit Tatimor/MFE	Anëtar
- Zj. Irma Shkrepa	Këshilltar, Kabineti/MFE	Anëtar
4. Njoftimi për fillimin e procedurës sipas këtij urdhëri i dërgohet menjëherë nga Sekretari i Përgjithshëm i MFE, Credit Line Steering Committee (CLSC) dhe të publikohet në faqen *web* të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), brenda datës 18.11.2020.
5. Afati i dorëzimit në zyrën e Protokollit të MFE të aplikimit dhe dokumenteve të përcaktuara në Aneksin 1 të këtij urdhëri, është deri më datë 7.12.2020\_\_\_\_, ora 14:00.
6. Komisioni i Vlerësimit për përzgjedhjen e kandidatit për pozicionin e Drejtorit të Njesisë së Menaxhimit të Programit (PMU) sipas këtij urdhëri, me administrimin e dokumenteve të aplikimit nga të interesuarit, brenda 2(dy) ditëve pune nga data e fundit e dorëzimit të tyre të përcaktuar në pikën 5 të Urdhërit, në përfundim të procesit i paraqet Ministrit të MFE raportin e vlerësimit të kandidatëve.
7. Ministri i MFE, me marrjen e raportit të Komisionit të Vlerësimit, miraton raportin dhe i dërgon menjëherë Credit Line Steering Committee (CLSC), propozimin për miratimin e emërimit të drejtorit të Njesisë Menaxhimit të Programit(PMU).
8. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, për zbatimin e urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

  
**MINISTËR**  
**Anila DENAJ**